



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA KOMBËTARE E MJEDISIT

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE
KORRIK 2026

Tiranë më 31.07.2026

Nr.	Data e kërkesës	Objekti i kërkesës	Data e përgjigjes	Përgjigjia	Statusi	Pagesa
Nr.1	01.07.2026	A ka aplikuar shoqëria S*** A*** D*** sh.p.k për kryerjen e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe nëse po, ku mund të japim sugjerimet tona për çështjet që duhen trajtuar në raportin e VNM-së?	13.07.2026	Në përputhje me dispozitat e ligjit Nr.10440 datë 07.07.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis” të ndryshuar, VKM Nr.686 datë 29.07.2015 “Për miratimin e rregullave, përgjegjësi e afateve për zhvillimin e procedurës së transferimit të Vendimit të Deklaratës Mjedisore” të ndryshuar, zhvilluesi “Z*** S*** A*** D***” nuk ka kryer aplikimin në sistemin e leje për zhvillimin e procedurës së VNM-së të Thelluar.	Përfunduar	Nuk ka
Nr.2	01.07.2026	1. Raportin teknik të propozuar; planimetrinë e vendndodhjes së projektit; planimetrinë e objekteve dhe të strukturave të	13.07.2026	Në përputhje me dispozitat e ligjit Nr.10440 datë 07.07.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis” të ndryshuar, VKM Nr.686 datë 29.07.2015 “Për miratimin e rregullave, përgjegjësi e afateve për zhvillimin e procedurës së transferimit të Vendimit të Deklaratës Mjedisore” të ndryshuar,	Përfunduar	Nuk ka

		projektit; raportin paraprak të VNM (VKM Nr. 686, datë 29. 7. 2015, i ndryshuar, "Për miratimin e rregullave, të përgjegjësi e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis", Kreu I, pika 1). 2.Vendimin e AKM për VNM Paraprake; arsyet ku bazohet vendimi dhe mendimin e institucioneve të konsultuara (Ligj Nr. 10440, 7. 7. 2011, i ndryshuar "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis", neni 11, pika 1 dhe 2).		zhvilluesi "Z*** South A*** D***" nuk ka kryer aplikimin në sistemin e_leje për zhvillimin e procedurës së VNM-së të Thelluar.		
Nr.3	02.07.2026	1-Vënien në dispozicion të Programit Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit, pjesën që lidhet me monitorimin e ujërave siipërafqësore për periudhën 2022-2026. 2-Cilat janë pikat zyrtare të monitorimit të cilësisë së ujit në Basenin Ujor Ishëm? Lutem specifikoni vendndodhjen e secilës pikë monitorimi. 3-Lutem na vini në dispozicion rezultatet e monitorimit të cilësisë së ujërave për periudhën 2022-2026 për: lumen Ishëm, degët kryesore të	06.07.2026	Programet Kombëtare të Monitorimit PKMM dhe Raportet e Gjendjes në Mjedis, RGJM të cilat përmbajnë informacion për cilësinë e ujërave të basenit të Ishmit, i gjeni në faqen e web-it të AKM-së në adresën: https://akm.gov.al	Përfunduar	Nuk ka

		tij, trupat ujorë që monitorohen në këtë basen. 4-Cili është statusi ekologjik dhe kimik i trupave ujorë në Basenin Ishëm sipas vlerësimit më të fundit të AKM-së. 5-Cilat janë burimet kryesore të ndotjes të identifikuara nga AKM në këtë basen dhe në cilat segmente janë konstatuar? 5-A ka konstatuar AKM tejkalime të standarteve të cilësisë së ujit gjatë viteve 2022-2026? Nëse po, të na vihen në dispozicion raportet përkatëse. 6-A janë njoftuar institucionet përgjegjëse (Ministria e Mjedisit, AMBU, bashkitë apo institucione të tjera) për problematikat e evidentuara gjatë monitorimit? Nëse po, cilat kanë qenë rekomandimet e AKM-së? 7-A disponon AKM raporte inspektimi, monitorimi apo dokumente të tjera që lidhen me ndotjen e Basenit Ujor ishëm? Nëse po, kërkojme kopje.				
--	--	---	--	--	--	--

		8-A ka kryer AKM monitorim ose vlerësim të efektivitetit të ndërhyrjeve të realizuara nga institucionet përgjegjëse në këtë basen. Nëse po, kërkojmë rezultatet.				
Nr.4	29.06.2026	Kërkoj të më vihet në dispozicion dokumentacioni që disponon Ministria e Mjedisit në lidhje me projektin: "Mbrojtja me prita malore e Përroit të Lekbibajt (Mërturit)", Bashkia Tropojë. Konkretisht, kërkoj: 1.Çdo dokument administrativ ose teknik që disponon Ministria në lidhje me këtë projekt. 2.Çdo korrespondencë ndërmjet Ministrisë, KESH sh.a., Agjencisë Kombëtare të Mjedisit (AKM), Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura (AKZM) dhe institucioneve të tjera lidhur me këtë projekt. 3.Çdo vendim, miratim, pëlqim ose akt administrativ të lëshuar nga Ministria në lidhje me projektin. 4.Çdo dokument që lidhet me vlerësimin e ndikimit të	15.07.2026	Në vijim të kërkesës në lidhje me projektin "Mbrojtja me prita malore e Përroit të Lekbibajt (Mërturit)", ju bëjmë me dije se: "K*** E*** Shqiptare" sh.a ka aplikuar me Nr AN160720250061 aplikimi, datë 16.07.2025 në lidhje me procedurën paraprake të VNM-së për projektin "Mbrojtja me prita malore e Përroit të Lekbibajt", me vendndodhje në pellgun ujëmbledhës të Lekbibajt. U vendos në dispozicion dosja e aplikimit.	Përfunduar	Nuk ka

		projektit mbi zonat e mbrojtura, habitatet natyrore, biodiversitetin dhe trupat ujorë. 5.Çdo dokument, hartë ose studim mbi të cilin është bazuar klasifikimi dhe emërtimi i rrjedhës ujore ku zhvillohet projekti. 6.Nëse ndonjë nga dokumentet e kërkuara administrohet nga një institucion tjetër, ju lutem, në përputhje me nenin 15 të Ligjit nr. 119/2014, ta përcillni kërkesën pranë institucionit kompetent ose të më informoni se cili institucion i disponon ato.				
Nr.5	14.07.2026	Kërkojmë nga AKM të na informojë zyrtarisht lidhur me : 1-A është AKM në dijeni të gjendjes së krijuar në zonën bregdetare pranë fshatit Adriatik? 2-Nëse po, cilat janë verifikimet, konstatimet dhe masat që janë ndërmarrë deri më sot nga institucioni juaj?	16.07.2026	AKM ushtron funksionet dhe kompetencat e saj në bazë të ligjit Nr.99/2024 “Për inspektimin në RSH”, ligjit Nr.10431/2011 “Për mbrojtjen e mjedisit” të ndryshuar, ligjit Nr.10448/2011 “Për lejet e mjedisit” të ndryshuar, ligjit Nr.57/2025 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” si dhe VKM Nr.568/2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të AKM-së”. Në zbatim të nenit 60, pika 1, shkronja g) të ligjit Nr.10431/2011 “Për mbrojtjen e mjedisit” të ndryshuar me ligjin Nr.66/2024 si dhe dispozitave të ligjit Nr.99/2024 “Për inspektimet në RSH”, Agjencia Kombëtare e Mjedisit ushtron funksionet e saj inspektuese ndaj operatorëve që zhvillojnë veprimtari të pajisura me leje mjedisore të tipit A dhe B duke kryer inspektime dhe kontrole për verifikimin e respektimit të	Përfunduar	Nuk ka

	3-Nëse nuk ka pasur dijeni deri në këtë moment, a do të kryhet një inspektim urgjent në terren pas marrjes së kësaj kërkesë? 4-Cili institucion mban përgjegjësi ligjore për administrimin, rehabilitimin dhe pastrimin e kësaj zone bregdetare? 5-A ekziston një plan konkret masash ose project institucional për pastrimin e mbetjeve të depozituara përgjatë kësaj vije bregdetare dhe për rikthimin e saj në gjendje normale? 6-A është parashikuar ose mbështetur nga institucionet përgjegjëse ndërtimi i urës që dikur ka ekzistuar në këtë zonë dhe që konsiderohet nga banorët si një element kyc për aksesin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e saj? 7-Cilat janë afatet konkrete Brenda të cilave pritet të ndërhyet për zgjidhjen e këtyre problematikave?	kushteve të lejeve mjedisore dhe kërkesave të legjislacionit mjedisor në fuqi. Lidhur me problematikën e paraqitur në kërkesën tuaj mbi depozitimin e mbetjeve urbane, plastike dhe materialeve të tjera në zonën bregdetare pranë fshatit Adriatik dhe Lagunës së Patokut, ju bëjmë me dije se trajtimi i kësaj problematike kërkon vlerësimin e ndarjes së kompetencave ndërmjet institucioneve përgjegjëse, në varësi të natyrës së problematikës së evidentuar. Referuar nenit 23 të ligjit Nr.57/2025 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, Agjencia Kombëtare e Mjedisit është institucion publik qendror në varësi të ministrit përgjegjës për mjedisin e cila ppër përmbushjen e qëllimit dhe objektivave të këtij ligji ushtron kompetenca në fushën e menaxhimit të integruar të mbetjeve. Për sa më sipër, kompetencat e AKM-së në fushën e menaxhimit të integruar të mbetjeve lidhjen kryesisht me administrimin e informacionit mjedisor, zbatimin e procedurave të vlerësimit të ndikimit në mjedis, licencimin e veprimtarive përkatëse dhe kontrollin e respektimit të kërkesave mjedisore nga subjektet që zhvillojnë veprimtari të pajisura me leje mjedisore. Ndërkohë në zbatim të nenit 24 të ligjit Nr.57/2025 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” bashkitë janë autoritetet përgjegjëse për organizimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit të integruar të mbetjeve në territorin nën juridiksionin e tyre, përfshirë ndarjen e mbetjeve në burim dhe grumbullimin e diferencuar të tyre. Gjithashtu, referuar pikës 2, shkronja d) dhe dh) të nenit 24 të ligjit Nr.57/2025, bashkitë kanë detyrimin për monitorimin dhe kontrollimin e territorit të tyre për qëllim parandalimin dhe mbikqyrjen e hedhjes së paligjshme të mbetjeve në vende të paautorizuara dhe/ose krijimit të venddepozitimeve të paligjshme të mbetjeve, si dhe në bashkëpunim me organet		
--	--	--	--	--

				kompetente, marrjen e masave për evidentimin e shkeljeve, mbledhjen e mbetjeve të hedhura në mënyrë të paligjshme dhe trajtimin e tyre sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi. Në të njëjtën linjë, ligji Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” u ngarkon njësive të vetëqeverisjes vendore përgjegjësinë për ofrimin dhe administrimin e shërbimit të menaxhimit të mbetjeve urbane, si dhe mbrojtjen e mjedisit në territorin e tyre. Për sa i përket problematikave që lidhen me ndërhyrje në territor, punime ndërtimore, mungesë ose dëmtim të veprave infrastrukturore apo cënim të hapësirave publike, këto çështje nuk përbëjnë objekt të drejtpërdrejtë të kompetencave të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, në mungesë të një lidhjeje të identifikuar me një operator që ushtron veprimtari të pajisur me leje mjedisore. Megjithatë në rast se gjatë verifikimeve identifikohet ndonjë operator ekonomik që ushtron veprimtari të pajisur me leje mjedisore sipas ligjit Nr.10448/2011 “Për lejet e mjedisit” të ndryshuar, dhe rezulton mosrespektim i kushteve të përcaktuara në lejen mjedisore, AKM në ushtrim të kompetencave të saj ligjore, do të ndërmarrë procedurat përkatëse të inspektimit dhe masat administrative të parashikuara në legjislacionin në fuqi.		
Nr.6	20.07.2026	Në afërsi të zonës së aeroportit të Vlorës, kërkoj: 1-Lejet Minerare: Kopje të lejeve minerare të shfrytëzimit të lëshuara nga institucionet përgjegjëse dhe të administruara/monitoruara nga AKBN për operatorët/subjektet që ushtrojnë aktivitetin e gurores në këtë perimetër.	21.07.2026	Në vijim të informacionit të kërkuar, administruar pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, pyetjet e drejtuara janë jashtë fushës së veprimtarisë dhe kompetencës së AKM-së referuar VKM-së Nr.568/2019 "Për mënyrën e krijimit, funksionimit dhe organizimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit". Nga përmbajtja e pyetjeve, rezulton se institucioni kompetet është Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN).	Përfunduar	Nuk ka

		2-Planet e Shfrytëzimit dhe Rehabilitimit: Kopje të projekteve të miratuara të shfrytëzimit dhe planeve të rehabilitimit të mjedisit për këto subjekte. 3-Raportet e Inspektimit Teknik: Kopje të çdo raporti kontrolli apo monitorimi të kryer nga strukturat e AKBN-së për këto subjekte, lidhur me zbatimin e kushteve teknike të shfrytëzimit dhe respektimin e koordinatave të lejuara. 4-Procesverbalet dhe Masat: Kopje të procesverbaleve të konstatimit, pezullimeve apo masave të mundshme administrative të marra nga AKBN për shfrytëzim jashtë kushteve të lejes ose pa leje minerare në këtë zonë.				
Nr.7	20.07.2026	1.A mund të konfirmoni se të gjitha stacionet e monitorimit të cilësisë së ajrit urban janë funksionale dhe matin të gjithë indikatorët e përcaktuar nga direktivat e BE-së, apo kemi ende boshllëqe të dukshme? 2. Sa stacione janë aktualisht jashtë funksionit dhe cilat janë arsyet konkrete për	28.07.2026	Agjencia Kombëtare e Mjedisit në përputhje me kompetencat e saj ligjore, monitoron cilësinë e ajrit nëpërmjet rrjetit të stacioneve të monitorimit të vendosura në territorin e vendit. AKM administron dhe mirëmban këto stacione, siguron mbledhjen, përpunimin dhe publikimin e të dhenave mbi cilësinë e ajrit si dhe vlerëson gjendjen e bazuar në standartet dhe legjislacionin në fuqi. Regjistri i Gjendjes së Mjedisit hartohet, publikohet dhe përditësohet në mënyrë të vazhdueshme nga AKM dhe në	Përfunduar	Nuk ka

		mosfunksionimin e tyre – mungesë buxheti, defekte teknike apo neglizhencë institucionale? 3.Plani Kombëtar për Menaxhimin e Cilësisë së Ajrit (VKM nr. 412/2019) parashikon shtimin e stacioneve të reja. A janë zbatuar këto masa, apo mbeten vetëm në letër? 4.A është laborator i AKM-së i akredituar si laborator kombëtar për kalibrimin e paisjeve që matin parametrat të cilësisë së ajrit, siç e kërkon VKM nr. 412/2019, apo ende operojmë pa një strukturë referencë të besueshme? 5.Sa fonde janë kërkuar nga AKM për akreditimin e laboratorit dhe sa janë alokuar realisht? Po për shtimin e numrit të stacioneve ka fonde? 6.Pse analizat e metaleve të rënda dhe PAH-ve nuk kryhen, kur direktiva e BE-së e kërkon qartë dhe kur këto ndotës kanë ndikim të drejtpërdrejtë në shëndetin publik?	përmbajtje të tij janë të gjithë informacionit e treguesve mjedisorë. Gjithashtu Agjencia Kombëtare e Mjedisit kontribuon në mbrojtjen e mjedisit dhe të shëndetit publik, duke monitoruar treguesit mjedisorë, hartuar raporte dhe ofruar informacion për institucionet përgjegjëse dhe publikun.		
--	--	---	--	--	--

		7.Pse të dhënat e cilësisë së ajrit në kohë reale nuk janë të aksesueshme publikisht, ndryshe nga praktikat e vendeve të BE-së? Çfarë pengese konkrete e ndalon transparencën? 8.Kur pritet të krijohet portali kombëtar transparent për cilësinë e ajrit, i premtuar prej vitesh? 9.Si justifikohet mungesa e komunikimit të qartë me publikun për nivelet e ndotjes, sidomos në zonat kritike si Tirana dhe Elbasani, ku ekspozimi i popullsisë është më i lartë? 10.Pse AKM nuk përmbush kërkesat e Direktivës 2004/107/EC për monitorimin e metaleve të rënda dhe PAH-ve? 11.Si shpjegohet që numri i stacioneve aktuale nuk përputhet me Planin Kombëtar të Menaxhimit të Cilësisë së Ajrit, i cili parashikon të paktën 10 stacione të reja? 12.Çfarë masash konkrete janë marrë për të siguruar që të dhënat të jenë të vlefshme mbi				
--	--	---	--	--	--	--

		75%, siç kërkon direktiva 2008/50/EC? Apo raportimet vazhdojnë të jenë të pjesshme dhe jo të besueshme? 13.Bazuar ne raportet e RGJM-se, në Elbasan, vlerat e PM10 dhe PM2.5 kanë tejkaluar ndjeshëm normat e BE-së. Pse nuk janë marrë masa konkrete reduktimi, kur rreziku për shëndetin e popullsisë është i dokumentuar? 14.Pse ka mospërputhje mes të dhënave të raportuara në EIONET dhe atyre të publikuara nga AKM?				
Nr. 8	20.07.2026	Gjatë punës sonë raportuese dhe vëzhgimeve në terren, ne kemi dëshmuar praninë dhe aktivitetin e disa operatorëve që kryejnë funksionin e thyerjes dhe përpunimit të gurëve brenda territorit të Zonës së Mbrojtur. Ky aktivitet po zhvillohet specifikisht në zonën jashtë rrethimit të kantierit të Aeroportit të Vlorës, por në afërsi të tij. Për të kuptuar bazën ligjore dhe mjedisore të këtij aktiviteti në një zonë me status mbrojtjeje, kërkoj të më vihet në	04.08.2026	Në vijim të informacionit të kërkuar, ju bëjmë me dije se: Të gjithë operatorët e pajisur me Leje Mjedisore me Kod III.1.B, III.1.C janë të publikuara në regjistrin kombëtar të autorizimeve, lejeve dhe licencave në QKB, bazuar në ligjin Nr.10081 datë 23.02.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në republikën e Shqipërisë”. Në linkun e mëposhtëm verifikoni Lejet e Mjedisit kategoria III.1 për ndikimin në mjedis si dhe licencat e nënkategorisë III.2.B: https://qkb.gov.al/leje-licensa-autorizime/ Në faqen zyrtare të AKM-së është e publikuar lista e subjekteve të pajisura me leje mjedisore Tipi A dhe B dhe licenca III.2.B për periudhën Janar 2014 - Qershor 2026: https://akm.gov.al/ova_doc/baza-e-te-dhenave-per-lejet-e-mjedisit-tipi-a-b-per-periudhen-janar-2014-korrik-2024/ https://akm.gov.al/ova_doc/baza-e-te-dhenave-per-licencat-iii-2-b-per-periudhen-2012-maj-2024/.	Përfunduar	Nuk ka

		dispozicion informacioni dhe dokumentacioni i mëposhtëm: Lejet mjedisore: Kopje të lejeve të vlefshme mjedisore të lëshuara për operatorët/subjektet që po ushtrojnë aktivitetin e gurores dhe thyerjes së gurëve në këtë perimetër. Lejet e shfrytëzimit: Kopje të lejeve të shfrytëzimit për këto subjekte (nëse janë lëshuar/miratur nga institucionet përkatëse). Raportet e kontrollit: Kopje të çdo raporti kontrolli apo monitorimi të kryer nga inspektorët e AKM-së, Inspektoriatit të Mjedisit, për këto subjekte në këtë zonë. Procesverbalet: Kopje të procesverbaleve të mbajtura në terren (përfshirë procesverbale konstatimi, pezullimi apo vendosje gjobe) gjatë inspektimeve të mundshme për këtë aktivitet.				
Nr. 9	23.07.2026	1. Ju lutem konfirmoni nëse keni konstatuar raste të ushtrimit të aktivitetit të nxjerrjes së inerteve lumore pa lejen përkatëse në territorin e	31.07.2026	Agjencia Kombëtare e Mjedisit nuk administron të dhëna statistikore për periudhën 2015–2020, lidhur me rastet e ushtrimit të aktivitetit të nxjerrjes së inerteve lumore pa lejen përkatëse, pasi funksioni i inspektimit dhe kontrollit u transferua pranë Agjencisë duke filluar nga data 1 Korrik 2020,	Përfunduar	Nuk ka

	Republikës së Shqipërisë në periudhën 2015-2026. 2. Nëse po, ju lutem të vini në dispozicion informacion mbi: a. numrin e rasteve të konstatuara, të ndara sipas qarqeve; b. lumin ose segmentin lumor ku është konstatuar aktiviteti; c. subjektin që ka ushtruar aktivitetin, nëse ky informacion disponohet; d. masat administrative të marra ose procedurat e ndjekura nga institucioni juaj, si edhe rastet e referuara pranë autoriteteve kompetente.	në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 568, datë 17.07.2019 "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit". Pas këtij transferimi, Agjencia Kombëtare e Mjedisit ushtron veprimtarinë e saj inspektuese vetëm brenda fushës së kompetencave të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi, të cilat konsistojnë në kontrollin e përputhshmërisë së operatorëve të pajisur me leje mjedisore me kushtet e lejes dhe kërkesat e legjislacionit mjedisor. Në përputhje me pikat 2 dhe 3 të Urdhrit të Inspektorit të Përgjithshëm Nr.29, datë 30.08.2023, Agjencia Kombëtare e Mjedisit ushtron veprimtarinë inspektuese vetëm për rastet e verifikimit të përputhshmërisë së aktivitetit të operatorëve me kushtet dhe kriteret e përcaktuara në lejet mjedisore, ndërsa në rastet kur inspektorët e saj marrin indicie ose konstatojnë ushtrimin e një aktiviteti pa leje mjedisore, njoftojnë pa vonesë Inspektoratin e Përgjithshëm dhe inspektoratin kompetent për ndjekjen e mëtejshme të çështjes. Në këtë kuadër, rastet e ushtrimit të aktivitetit të nxjerrjes së inerteve lumore pa lejen përkatëse, nuk përbëjnë objekt të drejtpërdrejtë të veprimtarisë inspektuese të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit. Referuar shkronjës "g" të pikës 3 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 509, datë 25.09.2025, strukturat përgjegjëse në varësi të Ministrisë së Punëve të Brendshme ushtrojnë përgjegjësi <i>për parandalimin, mbrojtjen, mbikëqyrjen dhe kontrollin e zbatimit të legjislacionit për mbrojtjen e territorit, tokës, ajrit, ujërave dhe pyjeve nga ndotja, dëmtimet apo ndërhyrjet e kundërligjshme.</i> Gjithashtu, neni 168 i Ligjit Nr. 29/2024 "Për burimet ujore" parashikon se kontrolli për verifikimin e respektimit të kërkesave të këtij ligji, kryhet nga inspektorati përgjegjës për kontrollin e mbrojtjes së territorit dhe organet përgjegjëse për inspektimin e mjedisit, secili në përputhje me kompetencat e përcaktuara në ligjin sektorial dhe në legjislacionin për inspektimin. Kur konstatohen shkelje të dispozitave të këtij ligji, dënimet administrative dhe masat e tjera përkatëse vendosen		
--	---	--	--	--

			nga inspektorati përgjegjës, në përputhje me kompetencat e tij ligjore. Gjithsesi, gjatë punës së saj, AKM, kryesisht nëpërmjet agjencive rajonale, ka trajtuar shqetësimet e ngritura për ndërhyrjet në shtretërit e lumenjve dhe shfrytëzimin e inerteve, duke kryer verifikime në terren. Gjatë këtyre verifikimeve janë konstatuar edhe raste të ushtrimit të aktivitetit pa autorizimet përkatëse për përdorimin e burimeve ujore, si dhe mosrespektim i kërkesave ligjore dhe mjedisore në fuqi. Konkretisht, gjatë inspektimeve të kryera nga strukturat e AKM-së në qarqet Berat, Elbasan dhe Korçë, janë konstatuar shkelje në subjektin “G*** shpk”, i cili ushtronte veprimtari të marrjes së inerteve lumore pa lejet përkatëse, për të cilat është vendosur masa administrative gjobë. Gjithashtu, në subjektin “V*** H***” u konstatua përdorimi i burimit ujqor dhe ndërhyrje në zonën lumore pa autorizimet përkatëse, për të cilin është vendosur masë administrative me gjobë, si dhe detyrime për ndërprerjen e veprimtarisë deri në pajisjen me lejet e nevojshme. Në një rast tjetër, pas trajtimit të një ankese ndaj subjektit “I***+”, gjatë verifikimit në terren u konstatua marrje e inerteve pa leje në shtratin e lumit, për të cilin është marrë masa administrative "Paralajmërim" dhe janë lënë detyra për ndërprerjen e veprimtarisë në kundërshtim me legjislacionin e burimeve ujore. Në mënyrë të përmbledhur ky informacion jepet në tabelën më poshtë: <table><tr><th>Subjekti</th><th>Vendndodhja</th><th>Lumi</th><th>Masa administrative</th><th>Data</th></tr><tr><td>V*** H***</td><td>NJA Mollas-Cërrik</td><td>Shkumbin</td><td>Gjobë</td><td>Mars 2024</td></tr><tr><td>G***SHPK</td><td>Afër fshatit Muriqan</td><td>Shkumbin</td><td>Gjobë</td><td>Shkurt 2025</td></tr></table>	Subjekti	Vendndodhja	Lumi	Masa administrative	Data	V*** H***	NJA Mollas-Cërrik	Shkumbin	Gjobë	Mars 2024	G***SHPK	Afër fshatit Muriqan	Shkumbin	Gjobë	Shkurt 2025		
Subjekti	Vendndodhja	Lumi	Masa administrative	Data																
V*** H***	NJA Mollas-Cërrik	Shkumbin	Gjobë	Mars 2024																
G***SHPK	Afër fshatit Muriqan	Shkumbin	Gjobë	Shkurt 2025																

				I***+	Zona e Pajovës, Peqin	Devoll	Paralajmërim	Qershor 2025		
Nr. 10	25.07.2026	1. A janë kompetencë e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe/ose Agjencive Rajonale të Mjedisit trajtimi dhe administrimi i ankesave të banorëve lidhur me ndotjen e ajrit dhe shqetësimet nga aromat e rënda të shkaktuara nga transportimi, depozitimi ose përdorimi i jashtëqitjeve të shpendëve në tokat bujqësore? 2. Në rast se po, lutemi të na informoni mbi procedurën që duhet të ndiqet për referimin dhe trajtimin e këtyre ankesave, përfshirë dokumentacionin dhe të dhënat që duhet të paraqiten. 3. Cili është institucioni kompetent për verifikimin në terren të ankesave lidhur me ndotjen e ajrit dhe aromat e rënda të shkaktuara nga përdorimi i jashtëqitjeve të shpendëve në tokat bujqësore? 4. A ka Agjencia Kombëtare e Mjedisit kompetencë për të kryer ose kërkuar monitorime dhe matje të cilësisë së ajrit në zonat ku raportohet shqetësim i përsëritur nga aromat e rënda të shkaktuara nga këto veprimtari?	04.08.2026	Në zbatim të VKM Nr. 568 datë 17.07.2019, Urdhëri i Kryeministrit Nr.29 datë 13.02.2024 "Për miratimin e strukturës dhe organikës së Agjencisë Kombëtare të Mjedisit", ju informojmë se AKM nuk ka detyra funksionale mbi monitorimin e odoreve (aromave). Laboratori i Agjencisë Kombëtare të Mjedisit kryen monitorimin e cilësisë së ajrit urban në përputhje me PKMM dhe informacion më të detajuar gjeni të publikuar në faqen zyrtare www.akm.gov.al.					Përfunduar	Nuk ka

		5. Nëse po, lutemi të na informoni: • cilët janë treguesit mjedisorë që mund të monitorohen në këto raste; • cila është procedura për kërkimin e një monitorimi mjedisor; • cilat janë institucionet ose strukturat përgjegjëse për realizimin e matjeve dhe vlerësimit të rezultateve. 6. A ekzistojnë kritere, standarde, udhëzime ose kërkesa mjedisore lidhur me mënyrën e transportimit, ruajtjes, depozitimit dhe përdorimit të jashtëqitjeve të shpendëve, me qëllim parandalimin ose kufizimin e aromave të rënda dhe ndikimeve të tjera negative në mjedis? 7. A duhet që subjektet që grumbullojnë, transportojnë, tregtojnë ose përdorin jashtëqitjet e shpendëve për fertilizimin e tokave të jenë të pajisura me leje, autorizime, regjistrime ose dokumentacion mjedisor të veçantë? 8. Nëse po, lutemi të na informoni: • llojin e lejes, autorizimit ose dokumentacionit që kërkohet;				
--	--	---	--	--	--	--

	• institucionin përgjegjës për lëshimin e tij; • kompetencat e AKM-së dhe/ose strukturave rajonale në verifikimin e respektimit të kushteve mjedisore. 9. A disponon Agjencia Kombëtare e Mjedisit të dhëna për ankesa, verifikime, inspektime ose masa administrative të ndërmarra në lidhje me ndotjen e ajrit, aromat e rënda ose problematika të ngjashme të shkaktuara nga përdorimi i jashtëqitjeve të shpendëve në tokat bujqësore? 10. Nëse një ankesë e tillë nuk është në kompetencën e drejtpërdrejtë të AKM-së, lutemi të na informoni se cilit institucion duhet t'i referohet problematika, si dhe për ndarjen e kompetencave ndërmjet institucioneve përgjegjëse për: • mbrojtjen e mjedisit dhe cilësinë e ajrit; • kontrollin veterinar dhe shëndetin e kafshëve; • përdorimin e plehrave organike dhe fertilizimit të tokave; • kontrollin e kushteve higjieno-sanitare dhe ndikimit në shëndetin publik.				
--	---	--	--	--	--

		11. Lutemi të më përcillni, nëse është e mundur, aktet ligjore, nënligjore, udhëzimet, rregulloret dhe dokumentet teknike përkatëse që përcaktojnë kompetencat dhe procedurat për trajtimin e kësaj problematike.				
Nr.11	24.07.2026	1-Kopje të gjitha raporteve të monitorimit të cilësisë së ajrit të kryera nga AKM në fshatin Marinëz për periudhën 2010-Korrik 2026, lidhur me aktivitetin e shoqërisë B*** P*** A***. 2-Kërkoj matjet e: H₂S (Sulfur i Hidrogenit), SO₂ Dioksid i Sulfurit), NO₂, (Dioksid i Azotit), CO dhe gazra të tjerë ndotës, VOC (kompinime organike të paqëndrueshme), PM₁₀ dhe PM 2.5 cdo ndotës tjetër atmosferik të monitoruar. 3-Kopje të cdo raporti monitorimi, matje ose kontrolli për zhurmat e shkaktuara nga aktiviteti i B*** P*** A*** , duke përfshirë sheshet e puseve, gjeneratorët, depot e grumbullimit dhe përpunimit të naftës, aktivitetet e tjera	31.07.2026	Nga verifikimi në regjistrin kombëtar të lejeve dhe licencave rezulton se subjekti B*** P*** A*** disponon lejet e mjedisit me Kod III.1. për ndikim në mjedis si vijon: 1- PN-0952-11-2010 me emërtim përshkrues veprimtarie Leje mjedisi e tipit B për: Magazinimi i naftës dhe nënprodukteve të saj në çisterna të palëvizshme në ndonjë terminal, ose ngarkim/shkarkimi i naftës dhe nënprodukteve të saj në/nga një çisternë e lëvizshme, çisternë hekurudhore ose anije e ujërave të brendshme në terminal me vend kryerje veprimtarie Vendburimi i naftës Patos-Marinëz, Fier. 2- PN-2012-01-2024 me emërtim përshkrues veprimtarie Stacion transferimi për mbetje të rrezikshme me vend kryerje veprimtarie Fier, Marinëz. 3- PN-3600-08-2016 me emërtim përshkrues veprimtarie Leje mjedisi e tipit A për: Incinerimi i mbetjeve të rrezikshme në një instalim incinerimi. Asgjësimi i mbetjeve të rrezikshme përveç incinerimit ose lëndëfillimit me vend kryerje veprimtarie Vendburimi i naftës Patos-Marinëz, në sheshin e pusit 2479-M, fshati Marinëz, Qarku Fier. 4- PN-4852-02-2013 me emërtim përshkrues veprimtarie Leje mjedisore për: Impiant i trajtimit të mbetjeve nga industria e	Përfunduar	Nuk ka

	industrial pranë zonave të banuara. 4-Kopje të cdo raporti, matjeje ose procesverbalit lidhur me pluhurat dhe grimcat në ajër të shkaktuara nga qarkullimi i mjeteve të rënda, aktiviteti i puseve, punimet industrial, transporti i naftës dhe materialeve. 5-Kopje të cdo raporti, monitorimi ose dokumentacioni mjedisor që AKM ka kryer vetë ose që i është dorëzuar B*** P***, A*** sh.a, institucione të tjera shtetërore, për ndikimin mjedisor të aktivitetit hidrokarbur në fshatin Marinëz. 6-Kopje të lejeve mjedisore, lejeve të zhvillimit të aktivitetit dhe akteve miratuese të dhëna nga AKM ose institucionet përgjegjëse për aktivitetin B*** P*** . Kërkohen vecanërisht dokumentet që lidhen me puse naftë, sheshe shpimi dhe prodhimi, depo naftë, impiante përpunimi, instalime teknologjike.	ekstraktimit të hidrokarbureve Fshati Marinëz (vendburimi Patos-Marinëz), Njësia Administrative Kuman, Qarku Fier. 5- PN-3509-08-2016 me emërtim përshkrues veprimtarie Leje mjedisi e tipit B për aktivitetin: Trajtimi i ujrave të ndotura industriale në vendin ku krijohen me vend kryerje veprimtarie Fshati Marinëz, Komuna Kuman, Qarku Fier. 6- PN-1088-03-2022 me emërtim përshkrues veprimtarie Trajtimi i ujrave të ndotura me vend kryerje veprimtarie Marinëz, qarku Fier (midis gropave ekologjike 3 dhe 4), bashkia Fier. 7- PN-3878-09-2016 me emërtim përshkrues veprimtarie Leje mjedisi e tipit A për: Kërkimi i naftës dhe i gazit natyror. Nxjerrja e naftës dhe e gazit natyror me vend kryerje veprimtarie Patos - Marinëz, Qarku Fier. 8- PN-2002-01-2024 me emërtim përshkrues veprimtarie Leje Mjedis e Tipit B për: Stacion transferimi për mbetje të rrezikshme që nuk përmenden më lart me vend kryerje veprimtarie FIER, Fshati Marinëz, Komuna Kuman. 9- PN-2000-01-2024 me emërtim përshkrues veprimtarie Leje Mjedis e Tipit B për: Stacion transferimi për mbetje të rrezikshme me vend kryerje veprimtarie FIER, Fshati: Marinëz Rruga: Qendër fshat Zona Kadastrale nr. 2599. 10- PN-2005-01-2024 me emërtim përshkrues veprimtarie Leje Mjedis e Tipit B për: Stacion transferimi për mbetje të rrezikshme që nuk përmenden më lart me vend kryerje veprimtarie në fushën naftëmbajtëse Patos-Marinëz, Qarku Fier. 11- PN-1682-03-2023 me emërtim përshkrues veprimtarie Menaxhimi imbetjeve, ID: 5.3 a. Asgjësimi i mbetjeve të	
--	---	---	--

	7-Kopje të dokumentacionit teknik ku përcaktohen distancat e objekteve të B*** P*** nga banesat, distancat nga qendrat e banuara, distancat nga tokat bujqësore, kushtet dhe kufizimet mjedisore për ushtrimin e aktivitetit. 8-Kopje të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, shtojcave teknike dhe dokumenteve shoqëruese për aktivitetet e B*** P*** në zonën e Patos Marinzës. 9-Kopje të planeve të menaxhimit mjedisor dhe raporteve të zbatimit të tyre nga B*** përfshirë masat për mbrojtjen e ajrit, masat për kontrollin e gazrave, masat për mbrojtjen e tokës dhe ujërave, masat për mbrojtjen e komunitetit. 10-Kopje të cdo inspektimi, procesverbal kontrolli, rekomandimi, urdhëri ose mase administrative të marrë ndaj B*** P*** A*** për periudhën 2010-2026 lidhur me ndotjen e ajrit, gazrat toksikë, zhurmat, pluhurat, ndotjen e tokës ose të	rrezikshme përveç incinerimit (5.1a) ose lanfillimit (5.2a) me vend kryerje veprimtarie Marinëz, Njësia Administrative Kuman, Bashkia Roskovec, Qarku Fier. Agjencia Kombëtare e Mjedisit monitoron Cilësinë e Ajrit Urban dhe të gjitha të dhënat janë të publikuara në Raportin e Gjendjes së mjedisit i cili është i aksesueshëm në faqen zyrtare të AKM-së në link https://akm.gov.al.		
--	---	---	--	--

		ujërave, shkelje të kushteve mjedisore. 11-Kopje të cdo ankese të administruar nga AKM ose strukturat e saj nga banorët e fshatit Marinëz lidhur me erën e gazit, ndotjen e ajrit, zhurmat, dëmtimin e tokave dhe kulturave bujqësore. 12-Kopje të cdo dokumenti që B*** ose A***i kanë vendosur në dispozicion AKM-së lidhur me incidentet teknologjike, rrjedhjet e gazit, avaritë e mbetjeve industrial. 13-Kopje të dokumentacionit mbi teknologjinë e përdorur nga B*** për nxjerrjen e naftës, ngrohjen dhe përpunimin e tij, përdorimin e kimikateve, trajtimin e mbetjeve industrial. 14-Kopje të listës së kimikateve dhe substanave të përdorura për procesin teknologjik të përpunimit të naftës, së bashku me dokumentet e sigurisë nëse disponohen. 15-Cdo document tjetër teknik, raport ose informacion që AKM disponon dhe që lidhet me				
--	--	---	--	--	--	--

		ndikimin mjedisor të aktivitetit B*** P*** në fshatin Marinëz. 16-Kopje të cdo marrëveshje, akti, kontrate, procesverbalit os dokumenti tjetër që dispononi lidhur me marrëveshjet e lidhura ndërmjet shoqërisë B*** dhe banorëve të fshatit Marinëz, vecanërisht banorëve të lagjes së varrezave që janë kufitar me sheshet, pusët, depot e naftës që ka bër kompania në Marinëz, për kompensimin, zhvendosjen e përkohshme ose trajtimin e pasojave të ndotjes së ajrit, gazrave, zhurmave apo ndikimeve të tjera mjedisore të shkaktuara nga aktiviteti i shoqërisë.				
Nr. 12	29.07.2026	Ne lidhje me aplikimin e subjektit “K*** E*** S***” sh.a, në lidhje me procedurën për njoftim të procedurës së thelluar të VNM-së për projektin “Hidrocentrali i Skavicës”, me vendodhje në luginën e Drinit të Zi. Subjekti e cila është refuzuar automatikisht nga sistemi i e_lejeve, pas tejkalimit të afatit ligjor, desha te di nese: 1. Nëse subjekti K*** E*** S*** sh.a ka riaplikuar për	29.07.2026	Agjencia Kombëtare e Mjedisit mori në shqyrtim aplikimin e subjektit “K*** E*** S***” sh.a, në lidhje me procedurën për njoftim të procedurës së thelluar të VNM-së për projektin “Hidrocentrali i Skavicës”, me vendndodhje në luginën e Drinit të Zi. Aplikimi është refuzuar automatikisht nga sistemi e-leje për mosplotësim dokumentacioni brënda afatit ligjor. Në lidhje me përditësimin e këtij procesi ju bëjmë me dije se: Subjekti nuk ka riaplikuar për kryerjen e procedurës së VNM-së së Thelluar.	Përfunduar	Nuk ka

		kryerjen e procedurës së VNM-së së Thelluar.				
Nr.13	29.07.2026	-Të dhënat mbi sasinë e mbetjeve urbane të gjeneruara dhe të grumbulluara nga Bashkia Tiranë për vitet 2023-2026. -Sasinë e mbetjeve të dërguara për depozitim, riciklim ose trajtim për secilin vit. -Raportet e monitorimit ose inspektimit që AKM ka kryer për menaxhimin e mbetjeve në territorin e Bashkisë Tiranë gjatë viteve 2023-2026. -Çdo shkelje, problematikë ose rekomandim të konstatuar nga AKM lidhur me menaxhimin e mbetjeve në Bashkinë Tiranë. -Të dhëna mbi rastet e ndotjes nga depozitimet e paligjshme të mbetjeve ose problematika të tjera të	03.08.2026	Të gjitha të dhënat e raportuara nga Bashkia Tiranë për mbetjet urbane në periudhën 2023-2025 janë të publikuara në Raportet e Gjendjes në Mjedis në faqen zyrtare web të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit. Gjithashtu në bazë të Vendimit Nr.687 datë 29.07.2015 “Për miramin e rregullave për mbajtjen, përditësimin dhe publikimin e statistikave të mbetjeve” të ndryshuar, Njësitë e Qeverisjes Vendore janë të detyruara të plotësojnë formatin e raportimit të statistikave vjetore të mbetjeve për mbetjet e krijuara në territorin e tyre, dhe këtë informacion e raportojnë në Agjencinë Kombëtare të Ekonomisë së Mbetjeve.	Përfunduar	Nuk ka

		evidentuara në territorin e Bashkisë Tiranë.				
--	--	--	--	--	--	--